



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 218/ 19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paqarizi – Kryetar, z. Blerim Dina –Referues dhe z. Goran Milenkovic-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “DWH- KOSOVA” shpk– Prishtinë, kundër aktivitetit të prokurimit: “Furnizim me instrument GPS”, me nr. prokurimi: 632-19-2948-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, më datën 22. 05. 2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “DWH- KOSOVA” shpk– Prishtinë, me nr. të protokolli 218/19, e datës: 17 maj 2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me instrument GPS”, me nr. prokurimi: 632-19-2948-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, pasi që ankuesi ka parashtruar ankesë jashtë afatit ligjor- katër ditë para hapjes së ofertave ne kundërshtim me nenin 4. a) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave .
- II. I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Gjakovës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me instrument GPS”, me nr. prokurimi: 632-19-2948-136, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).
- III.** Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 4. a) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave .
- IV.** Me qenë se ankesa e OE “DWH- KOSOVA” shpk– Prishtinë, hedhet si e pa lejuar i bëhet kthimi

i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 17. 05. 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “DWH- Kosova” sh. p. k– Prishtinë, me nr. te protokollit 218/19 për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument GPS”, me nr. prokurimi: 632-19-2948-136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Data e njoftimit për kontratë: 09.05.2019

Lloji i procedurës së aplikuar: Koutim çmimi

Kriteri për dhënie të kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 13. 05. 2019

Data e hapjes së ofertave: 17. 05. 2019

Vendimi lidhur me kërkesën për rishqyrtim nga AK është bërë me datën 16. 05. 2019

Pas pranimit të ankesës paneli shqyrtues ka mbajtur me datën: 22.05.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues konstaton se AK ka publikuar njoftimin për kontratë me datën 09. 05. 2019, Procedurë e hapur, me kriter për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 13. 05. 2019 ndërkaq data e hapjes së ofertave 17. 05. 2019.

Paneli shqyrtues konstaton se bazuar ne nenin 4. 1 pika (a) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave thuhet: a) **Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

Andaj OSHP duke pasur parasysh faktin se OE ankues nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontratë brenda afatit prej 5 ditëve, i njëjti ka humbur afatin ligjor për parashtrim te kërkesës për rishqyrtim në autoritetin kontraktues dhe OSHP nuk mund te shqyrtoj ankesën në fjalë për faktin se ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim konform nenit 4. 1 a) të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “DWH Kosova” - SH.P.K. Prishtinë, me nr. te protokollit 218/19 dhe ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik i cekur si me lart është e pa lejuar pasi që ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK që ka pasur të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit **(4) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi



Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- Komuna Gjakovës
2. 1x1 OE “DËH Kosova” - SH.P.K. Prishtinë
3. Arkivës së OSHP-së